

Rajmonda Kurshumlia, Valdete Bicurri, Albana Dujaka

# PROJEKTE PËR TË LEXUARIT ME KUPTIM LEXIM-KUPTIMI DHE ZHVILLIMI I TË MENDUARIT KRITIK



3

## LEXIM-KUPTIMI DHE ZHVILLIMI I TË MENDUARIT KRITIK

LIBRI I MËSUESIT/ MËSUESES

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Zbuloj figurën  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare dhe ato jo letrare;</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës : :I.6,III.3 ,IV.2  Rezultatet e fushës së kurrikulës: :1.1,3,4,; 2.2,5; 3.5  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare, Njeriu e natyra, Arti figurativ.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Bashkon pikat në figurën e dhënë.  -Përshkruan kafshën që paraqitet në figurë  -Shkruan disa fjali për gjirafën  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxiten nxënësit që të vërejnë figurën dhe të paramendojnë se cila kafshë mund të paraqitet pas bashkimit të pikave.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Udhëzohen nxënësit të bashkojnë pikat sipas numrave me radhë. Pasi të bashkojnë të gjitha pikat, diskutojmë se cilat kafshë dolën në figurë. Pyeten nxënësit se çfarë dinë rreth gjirafës dhe rreth elefantit. Informatat që japin nxënësit, shënohen në tabelë.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit do të shkruajnë në vijat poshtë figurës disa fjali rreth gjirafës dhe disa fjali rreth elefantit. Si fjalë kyçe do u shërbejnë informatat që janë të shkruara në tabelë. Nxiten të përshkruajnë sa më shumë detaje dhe fakte rreth këtyre kafshëve.</p>
<p><b>Hapi 4</b>  Lexohen shkrimet nga disa nxënës dhe diskutohet rreth tyre.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli. Mësuesja/ mësuesi kujdeset që të ketë informatë kthyesë për punën e të gjithë nxënësve.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Gjirafa dhe elefanti (Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: : I.4,5,7,10; II.4,6; III.2,5,7  Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.2; 2.3,6; 3.1,4,5  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare, Njeriu e natyra.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Shpreh idetë e tij/saj për temën e dhënë.  -Analizon përrallën.  -Nxjerr porosinë e përrallës.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Në tabelë mësuesja vizaton një rreth dhe në mes të tij shkruan fjalën “Miqësia”. Kërkon nga nxënësit që të japin mendimet e tyre se çfarë kuptimi ka për ata kjo fjalë .Mësuesja krijon një pemë mendimesh me përgjigjet e nxënësve.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Mësuesja lexon tekstin duke u ndalur pas çdo paragrafi dhe bën pyetje:  -Për kë mendoni se flitet në këtë përrallë?  -A mendoni se kafshët mund të kenë miqësi mes veti?  Mësuesja vazhdon leximin dhe vazhdon me pyetje pas çdo paragrafi.  -Pse e prishën miqësinë kafshët në përrallë?  -Kush e kishte fajin?  -A ju ndihmoi dikush të zgjidhnin problemin?  -Si përfundoi përralla?</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Lexohet teksti nga disa nxënës. Pas leximit nxiten nxënësit të nxjerrin mesazhin e kësaj përralle.</p>
<p><b>Hapi 4</b>  Nxënësit do të gjejnë fjalët e reja në tekst. I kërkojnë ato në fjalor fizik apo në internet. Pastaj plotësohet fleta e librit tek fjalorthi duke plotësuar rubrikat përkatëse.  Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen sipas teknikës “Dy yje, një dëshirë”</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Gjirafa dhe elefanti (Lidhjet, Shkruaj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: . I.1, 3, 4, 5, 6; II.1, 4,5,7; III. 1,2,4,5 ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: : 1.2; 2.3,6; 3.1,4,5  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Lexon fjalitë e dhëna.  -Lidh fjalitë sipas kuptimit.  -Shkruan fjalitë e fituara.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit do të lexojnë me kujdes fjalitë e dhëna në libër.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Udhëzohen të lidhin fjalitë në anën e majtë me fjalitë në anën e djathtë sipas kuptimit.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Pasi të kryejnë lidhjen e fjalive, ata do të shkruajnë fjalitë e reja të fituara.</p>
<p><b>Hapi 4</b>  Lexohen fjalitë e shkruara nga nxënësit. Mësuesja korrigjon nëse lidhja e fjalive nuk është bërë si duhet.  <b>Vlerësimi:</b> Për vlerësimin e nxënësve përdoret lista e kontrollit. Mësuesja/ mësuesi kujdeset që të ketë informatë kthyesë për punën e të gjithë nxënësve.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Gjirafa dhe elefanti (Vizatoj sipas tregimit, Përmbledhja)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: . I.1, 3, 4, 5, 6; II.1, 4,5,7; III. 1,2,4,5 ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat, foto të gjirafës dhe elefantit.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Arti figurativ.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Vizaton në bazë të tekstit.  -Prezanton punën e vet para klasës.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Mësuesja paraqet në tabelë apo në TV, sipas mundësive, fotografi të gjirafës dhe elefantit.  Nxënësit do të vizatojnë dy kafshët, për të cilat lexuan në përrallë.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Pasi të kryhen vizatimet dhe ngjyrosjet, nxënësit janë të lirë të ecin nëpër klasë dhe të shikojnë vizatimet e shokëve dhe të shoqeve. Ata mund të zgjedhin vizatimin më të bukur.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Tani, udhëzohen nxënësit të shkruajnë një përmbledhje për përrallën Gjirafa dhe Elefanti dhe të nxjerrin porosinë e tregimit. Nxënësit duhet të kenë kujdes drejtshkrimin. Në fund, dyshet brenda bankave shkëmbejnë librat dhe lexojnë punimet e njëri-tjetrit.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit bëjnë vlerësim të ndërsjellë - Turi i galerisë (për vizatimet), Kontrollim para fluturimit (për përrallën e shkruar).</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Grindja e notave (Mendoj dhe shkruaj, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 4, 5; ; III- 2, 4; IV-8, ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi, goma.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore  -Shkruan fjali me fjalët e dhëna.  -Analizon vjershën.  -Përdor fjalorin.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Mësuesja bashkëbisedon me nxënësit rreth fjalëve, si: notat, mësuesi/ mësuesja, nxënësit, ditari etj. I pyet nxënësit ku përdoret ky fjalor dhe a mund të krijojnë fjali duke përdorur këto fjalë. Nxënësit shkruajnë fjalitë e krijuara në libër. Disa prej fjalive të shkruara lexohen.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet vjersha “Grindja e notave”. Analizohet çdo strofë veç e veç. Hapet diskutim në klasë rreth notave që marrin nxënësit. U jepet mundësia nxënësve të shprehin mendimet e veta se a duhet të mësojnë nxënësit vetëm për notë, apo për dije.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Realizohet faqja e librit te Fjalorthi. Nxënësit gjejnë fjalët e reja në vjershë, pastaj bashkë me mësuesen gjejnë kuptimin e tyre në fjalor.  <b>Vlerësimi</b> : Vëzhgim dhe listë kontrolli.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Grindja e notave (Përgjigjem, Mendoj dhe shkruaj, Fytyrat e notave)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon poezinë si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: I.1,3,4,6, II.1, III.1,2 , 4 , 7 , III .1,3, 4;  Rezultatet e fushës së kurrikulës 1.4 7, 9; 2.5, 6; 3. 7.8  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:  -Lexon vjershën me vëmendje  -Përgjigjet në pyetjet e dhëna  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Udhëzohen nxënësit të fillojnë punën në përgjigjet e pyetjeve që janë paraqitur në libër. Duke kërkuar përgjigjet në pyetjet e shtruara, nxënësit rikthehen dhe lexojnë vjershën sipas nevojës. Disa nga përgjigjet lexohen dhe diskutohen në klasë.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Mësuesja parashtron pyetjen: Si ndjeheni kur vlerësoheni me notë? Nxënësit shprehën për gjendjen e tyre emocionale kur vlerësohen me 5,4 apo notë më të ulët. Udhëzohen nxënësit të punojnë në libër, duke u shprehur me shkrim se si ndihen dhe çfarë bëjnë kur marrin nota të ndryshme: 5,4,3,2,1. Edhe nëse nuk kanë marrë ndonjëherë ndonjë prej notave, ata shkruajnë se çfarë duhet të bëjnë nëse ju ndodh të marrin notën e caktuar në të ardhmen. Sipas ndjenjave të veta ndërlidhur me notat e ndryshme, nxënësit përcaktojnë nga një fytyrë për secilën notë (për shembull: fytyrë e gëzuar, fytyrë jo aq e gëzuar, fytyrë e mërzitur, fytyrë e përlotur etj).</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Lexohen, analizohen dhe diskutohen disa nga shkrimet.</p>
<p><b>Hapi 4</b>  Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta dhe për shkrimet e krijuara.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje</p> <p>Njësia mësimore: Majmuni dhe delfini (Të shprehurit me vizatim)</p> <p>Tema: Tekste letrare dhe jo letrare</p> <p>Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: I- 4, 5; ; III- 2, 4; IV-8, ;</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,</p> <p>Mjetet e punës: libri, lapsi.</p> <p>Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare, Njeriu e natyra, Arti figurativ.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Tregon për gjallesat që jetojnë në det.</li> <li>-Vizat disa gjallesa që jetojnë në det.</li> <li>-Analizon personazhet në përrallë.</li> </ul> <p>Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b></p> <p>Mësuesja fillon bisedën me nxënësit duke parashtruar pyetjen: A ju pëlqen të shkoni në det? A dini cilat gjallesa jetojnë në det? Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin në libër disa gjallesa që jetojnë në det. Nxënësit emërtojnë gjallesat e vizatuara, duke i prezantuar ato para klasës.</p>
<p><b>Hapi 2</b></p> <p>Lexohet teksti Majmuni dhe Delfini. Leximi bëhet pjesë-pjesë dhe gjatë leximit, mësuesja/ mësuesi parashtron pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A e dini çfarë janë marinarët?</li> <li>-Ku mendoni se do të shkojnë ata me anije?</li> <li>-Kush e shpëtoi majmunin?</li> <li>-Si ju duket mburrja e majmunit?</li> <li>-Çfarë mësuat nga kjo përrallë?</li> </ul>
<p><b>Hapi 3</b></p> <p>Nxënësit analizojnë dhe diskutojnë në nivel klase tekstin e lexuar.</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në orë të mësimi.</p>



<p>Fusha: Mësim me zgjedhje</p> <p>Njësia mësimore: Majmuni dhe delfini (Fjalorthi, Shkruaj)</p> <p>Tema: Tekste letrare dhe jo letrare</p> <p>Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I.1,3,4,6, II.1, III.1,2 , 4 , 7 , III .1,3, 4;</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 7, 9; 2.5, 6; 3. 7.8</p> <p>Mjetet e punës: libri, lapsi.</p> <p>Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përgatitë fjalorthin për tekstin e lexuar.</li> <li>-Shkruan dialogun mes personazheve.</li> <li>-Shkruan porosinë e përrallës.</li> </ul> <p>Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b></p> <p>Kërkohet nga nxënësit që të përgatiten fjalorthit për tekstin Majmuni dhe Delfini. Secili nxënës lexon e rilexon tekstin duke kërkuar fjalët e reja. Pastaj, listohen në fjalorth dhe kërkohen në fjalor fizik apo në internet.</p>
<p><b>Hapi 2</b></p> <p>Bëhet një dramatizim I bisedës mes majmunit dhe delfinit. Nxënësit mund të shtojnë edhe fjalë tjera sipas imagjinatës së tyre. Kërkohet nga nxënësit të krijojnë nga një dialog në mes të majmunit dhe delfinit. Disa nga punimet lexohen, analizohen dhe komentohen.</p>
<p><b>Hapi 3</b></p> <p>Nxënësit shkruajnë porosinë e përrallës. Disa nga punimet lexohen, analizohen dhe komentohen.</p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për shkrimin e porosisë së përrallës</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Majmuni dhe delfini (Përgjigjem, Krahasoj, Shkruaj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I.1,3,4,6, II.1, III.1,2  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 7, 9; 2.5, 6;  Mjetet e punës: libri, lapsi, goma  Ndërlidhja me lëndët tjera: Gjuhë amtare, Njeriu e natyra.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Analizon përrallën përmes pyetjeve  -Përgjigjet me shkrim në pyetjet e dhëna.  -Krahason personazhet në mes vete.  -Shkruan një letër për personazhin e tregimit.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit udhëzohen që të përgjigjen në pyetjet e dhëna në libër, në mënyrë individuale.  U shpjegohet se këto pyetje do t'i ndihmojnë në kuptimin më të thellë të përrallës dhe mesazhit që ajo përmban. Në kërkim të përgjigjeve, nxënësi lexojnë e rilexojnë tekstin në heshtje. Disa nga përgjigjet e dhëna, lexohen në nivel klase.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Diskutohet me nxënës rreth kafshëve që përmenden në përrallë. Kërkohe nga nxënësit të mendojnë për të përbashkëtat e personazheve, si dhe për ndryshimet në mes tyre.  Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë Diagramin e Venit.  Pastaj, në dyshe analizojnë, krahasojnë dhe diskutojnë shkrimet me njëri -tjetrin.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Udhëzohen nxënësit të shkruajnë një letër për majmunin, t'i japin këshilla se si të sillen më mirë herën tjetër me miqtë që e ndihmojnë. Mësuesja sqaron se si shkruhet një letër. Jep këshilla për mënyrën e shkrimit dhe përmbajtjen e letrës. Disa nga letrat lexohen, analizohen dhe diskutohen në nivel klase.</p>
<p><b>Vlerësimi:</b>  Komentohen përgjigjet e nxënësve, diagramet e plotësuara dhe letrat e shkruara. Të gjitha këto renditen në portofolat e nxënësve.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Miu në restaurant (Tregoj, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: : I.4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera :Shkathtësi për jetë, Gjuhë amtare,</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Përshkruan ushqimet që i pëlqejnë.  -Analizon personazhet e përrallës.  -Përgatitë fjalorthin për tekstin e lexuar.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Bisedohet me nxënës rreth ushqimeve të tyre të preferuara. Po ashtu bisedohet rreth ushqimeve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme. Kërkohet nga nxënësit të paraqesin ushqimet e preferuara sipas kërkesës në libër. Ushqimet mund të paraqiten me vizatim, me shkrim, apo me të dy llojet e të shprehurit. Disa nga punimet e nxënësve lexohen para klasës.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet teksti pjesë-pjesë. Gjatë leximit, mësuesja bën pyetje:  -Për kë mendoni se bëhet fjalë në këtë tekst?  -Ku shkoi miu i vogël?  -Çfarë e këshilloi nëna e tij?  -A e përfilli miu këshillën e nënës?  -Si përfundoi tregimi?  -Si do silleshit ju?  Pas leximit, teksti diskutohet në nivel klase.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit, duke lexuar e rilexuar tekstin në heshtje, përgatisin fjalorthin. Kërkohen fjalët e reja në fjalor fizik apo në fjalor në internet.  <b>Vlerësimi:</b> Dy yje, një dëshirë.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Miu në restaurant (Unë dhe personazhi, Mendoj me zë të lartë, Të shprehurit me vizatim)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: I.4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Art figurativ.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:  -Krahason sjelljet e veta në restaurant dhe sjelljet e personazhit.  -Përgjigjet në pyetjet e parashtruara në libër.  -Vizaton sipas tekstit të lexuar.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Fillohet me pyetje:  - A shkoni shpesh në restaurant?  -Çfarë ju pëlqen më shumë në restaurant?  -Çfarë ju pengon më shumë në restaurant?  -Si silleni në restaurant?  Kërkohet nga nxënësit të punojnë sipas kërkesave në libër, duke krahasuar sjelljet e veta në restaurant me ato të personazhit. Lexohen në nivel klase disa nga shkrimet.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Udhëzohen nxënësit që duke lexuar e rilexuar tekstin, të përgjigjen me kujdes në pyetjet e dhëna në libër. Mësuesja sqaron llojet e pyetjeve (Pyetje të lehta dhe Pyetje të thella).  Kërkon nga nxënësit t'i lexojnë pyetjet me kujdes dhe të përipiqen tu përgjigjen atyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Lexohen përgjigjet e shkruara nga nxënësit.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit vizatojnë disa elemente nga teksti, duke u përqendruar te miu, restoranti, ushqimet.  Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë vizatimet e njëri-tjetrit.  Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta si dhe bëhet vlerësimi i ndërsjellë për vizatimet.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Moxarti, një fëmijë me fat (Fjalorthi, E vërtetë apo gabim)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon tekstet letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 4, 5; ; III- 2, 4; IV-8, ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Edukatë muzikore.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Analizon tekstin e lexuar.  -Diskuton për Moxartin.  -Identifikon faktet e vërteta dhe faktet e gabuara për Moxartin.  -Përgatitë fjalorthin në lidhje me tekstin e lexuar.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Hapet diskutim me pyetjet:  -A ju pëlqen muzika?  -Cili instrument ju pëlqen më shumë? Pse?  Paraqitet një fotografi e Moxartit, në tabelë ose në TV. Parashtrohet pyetja: A e keni parë këtë foto ndonjëherë më parë?  -A e keni dëgjuar fjalën kompozitor ndonjëherë?  Mësuesja lëshon në TV apo CD një pjesë të shkurtër nga një kompozim i Moxartit.  -A e dini çfarë është biografia?  Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive me shënime në Listën e kontrollit</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet teksti nga nxënësit dhe nënvizohen fjalët e panjohura, duke përgatitur fjalorthin.  Kërkohen fjalët e reja në fjalor fizik ose fjalor në internet.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Kërkohet që nxënësit ta lexojnë tekstin edhe një herë në heshtje dhe të përpiqen të mbajnë në mend sa më shumë fakte. Pastaj, fokusohen te pjesa E vërtetë apo e gabuar. Shënjojnë me V për e vërtetë dhe me G për e gabuar. Nxënësit korrigjojnë faktet e dhëna gabim duke i shkruar ashtu si janë saktë. Lexohen nga nxënësit fjalitë e shkruara, dhe komentohet rreth tyre.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive gjatë gjithë fazave të orës, duke mbajtur listë kontrolli.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Moxarti, një fëmijë me fat (Të shprehurit me vizatim, Gjej fjalët, shkruaj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon tekstet letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: I- 5 ,III.2,IV.8  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Art figurativ, Edukatë muzikore.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:  -Paraqet me vizatim instrumentin muzikor më të dashur.  -Gjen fjalët në drejtkëndëshin e shkronjave.  -Formon fjali më fjalët e gjetura.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit udhëzohen të paraqesin instrumentin muzikor më të dashur për ta përmes vizatimit.  Diskutohet për instrumentet e dashura të nxënësve.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Nxiten nxënësit të gjejnë fjalët e dhëna në drejtkëndëshin e shkronjave. Fjalët ngjyrosen me ngjyra sipas dëshirës. Në rubrikën shkruaj, nxënësit formojnë nga një fjali me secilën fjalë të gjetur në drejtkëndëshin e shkronjave.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Lexohen fjalitë e formuara.</p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për fjalitë e formuara.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Pse qielli është blu (Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon tekste letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 1. II,1,4 IV.5  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,4,9 2.3,5  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Paraqet fakte të gjetura në enciklopedi.  -Dallon tekstin informues nga ai letrar.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nga nxënësit kërkohet një ditë më parë të sjellin në klasë enciklopedi për fëmijë. Diskutohet për përmbajtjet dhe rolin e enciklopedive të fëmijëve. Nxënësit shfletojnë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin fotot dhe informatat që paraqiten në enciklopedi.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Mësuesja jep një hyrje në tekst duke shpjeguar që teksti është marrë nga një enciklopedi për fëmijë. Lexohet teksti. Mësuesja sqaron që teksti ka karakter informues dhe nuk është tregim që ka personazhe. Teksti diskutohet në nivel klase.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit lexojnë në heshtje tekstin dhe nënvizojnë fjalët e panjohura.  Këto fjalë gjenden bashkë me mësuesen në fjalor. Plotësohen rubrikat në faqen e librit të fjalorthi.</p>
<p><b>Vlerësimi</b> : Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në mësim duke mbajtur shënime në listë kontrolli.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Majlinda Kelmendi (Kampionët, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon tekste letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3,5 III,2.3  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,, 2 1,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Edukatë fizike dhe sportive, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Përshkruan sportistin e preferuar  -Ngjyros figurat në libër  -Analizon tekstin e lexuar.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Mësuesja paraqet fotografi të disa sportistëve të njohur. Kërkon nga nxënësit ti emërtojnë ata dhe të tregojnë se çfarë sporti luajnë. Nxënësit flasin për sportet dhe sportistët e tyre të preferuar. Ata ngjyrosin medaljet që gjenden në libër (të artën, të argjendtën, të bronzit).</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Në tabelë apo TV, mësuesja paraqet fotografinë e Majlinda Kelmendit. Nxiten nxënësit të tregojnë se çfarë dinë për këtë sportiste të njohur dhe llojin e sportit që ajo luan. Lexohet teksti. Hapet diskutim. A duhet të ketë lloje të sporteve veç për djem dhe veç për vajza. Nxiten nxënësit të marrin pjesë sa më shumë në diskutim.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Duke rilexuar tekstin në heshtje, nxënësit gjejnë fjalët e reja dhe punojnë në rubrikën Fjalorthi.</p>
<p><b>Hapi 4</b>  Nxënësit do të tregojnë se cili lloj sporti iu pëlqen më shumë dhe cilin sportist e adhurojnë më shumë.  Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive gjatë të gjitha fazave të orës, duke përdorur listën e kontrollit.</p>



<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Majlinda Kelmendi (Parashikoj, Pyetjet pas leximit, Hulumtoj dhe krijoj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon tekstet letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 4, 5; III- 1,2, 4; IV-8, ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Edukatë fizike dhe sportive, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Shkruan për profesionin e ardhshëm  Përgjigjet në pyetjet e dhëna në libër  -Krijon poster për Majlinda Kelmendin  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit udhëzohen të punojnë në libër, duke treguar për ndonjë profesion në të cilin dëshirojnë të bëjnë karrierë, kur të rriten. Disa nga shkrimet e nxënësve lexohen në klasë.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Udhëzohen nxënësit të lexojnë me kujdes pyetjet e dhëna në libër dhe të japin përgjigje në to.  Lexohen disa nga përgjigjet e dhëna.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit ndahen në grupe dhe krijojnë postere me gjërat që i kanë sjellë në klasë. Posteret vendosen në muret e klasës. Secili grup prezanton punën e bërë.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta ndërsa puna e grupeve në postera vlerësohet me vlerësim të ndërsjellë.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Stinët e vitit (Të shprehurit me vizatim, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare dhe ato joletrare;</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës: : I.4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1 1.4 ,  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8</p> <p>Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Art figurativ, Gjuhë amtare, Njeriu dhe natyra.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:  -Vizatim stinët e vitit  -Analizon vjershën  -Përgatitë fjalorthin  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë stinët e vitit. Pastaj do të tregojnë se cila stinë ju pëlqen më shumë. Në rubrikat përkatëse nxënësit do të vizatojnë pamje të natyrës në katër stinët e vitit. Nxënësit analizojnë vizatimet e shokut/shoqes së bankës dhe mund ti japin ide njëri-tjetrit që vizatimi i tyre të del sa më bukur.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet vjersha dhe analizohet e diskutohet çdo strofë.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Duke lexuar në heshtje, kërkohet që nxënësit të nënvizojnë fjalët e reja për ta. Nxënësit punojnë në rubrikën Fjalorthi.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive gjatë gjitha fazave të orës.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Stinët e vitit (Kodimi, Shkruaj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon poezinë si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: .4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1 1.4  Rezultatet e fushës së kurrikulës: : 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Analizon vjershën.  -Kodon sipas udhëzimeve.  -Plotëson detyrat e dhëna në libër.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit udhëzohen të punojnë në rubrikën Kodim, teksa rilexojnë vjershën. Lexohen dhe diskutohen disa prej kodimeve të bëra.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Sipas udhëzimeve n libër, nxënësit zgjedhin strofën e pëlqyer dhe shkruajnë arsyet pse iu pëlqeu. Lexohen disa prej shkrimeve.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Sipas udhëzimeve në libër, nxënësit shkruajnë për secilën stinë nga disa fjali përmes të cilave do të tregojnë se pse iu pëlqen ajo stinë dhe çfarë të mira sjell ajo. Nxënësit lexojnë shkrimet e tyre para klasës.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për shkrimet e tyre.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Bonbonet e mençura (Shijet e lëndëve, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon përrallën si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I.4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Përshkruan lëndët mësimore.  -Krahason lëndët mësimore me ushqimet.  -Analizon tekstin.  -Përgatitë fjalorthin.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  -Parashtrohet pyetja:  -Cila lëndë mësimore iu pëlqen më shumë?  -Me çfarë ushqimi do ta krahasonit lëndën mësimore që ju pëlqen? Etj.  Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Udhëzohen nxënësit të punojnë në rubrikën Shijet e lëndëve.  Kërkohet të jenë sa më kreativ në përgjigje. Lexohen disa nga përgjigjet e nxënësve.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet teksti me paragrafë nga nxënësit. Pas leximit të çdo paragrafi diskutohet, duke u drejtuar nxënësve pyetje, si më poshtë:  -A mund të imagjinoni që lëndët mësimore të shiten në dyqan si ushqime e pije?  -Do kishit dashur të vizitonit planetin BU? Etj.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit punojnë në rubrikën Fjalorthi. Bashkëpunojnë në çifte për gjetjen e kuptimeve të fjalëve të panjohura. Nxënësit duhet të shpjegojnë kuptimin e fjalëve duke përdorur fjalorin dhe kontekstin e përgjithshëm të tekstit, duke rilexuar tekstin sipas nevojës.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive gjatë gjitha fazave të orës.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Bonbonet e mençura (Lexoj dhe plotësoj, Shkruaj)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon poezinë si tekst letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkollës: I.4,7,10 ;II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1</p> <p>Rezultatet e fushës së kurrikulës: : 1.4 ,7,10; 2.2,5; 3.2, 7,8</p> <p>Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Njeriu dhe natyra, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:  -Analizoj tekstin.  -Plotëson fjalitë në libër sipas kërkesave.  -Krijon një vjershë qesharake.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit punojnë në rubrikën Lexoj dhe plotësoj, duke lexuar tekstin në heshtje, sipas nevojës.  Lexohen disa nga punimet.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Zhvillohet një bisedë me nxënësit duke i nxitur ata të mendojnë se një ditë mund të bëhen shkrimtar të vërtetë. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë një vjershë qesharake, të imagjinojnë sikur kanë pirë lëngun magjik të gjuhës shqipe. Nxënësit shkruajnë sipas imagjinatës së tyre.  Nxënësit ulen me radhë në karrigen e autorit dhe lexojnë vjershat para klasës.</p>
<p><b>Vlerësimi</b>  Nxënësit vlerësohen për vjershën e shkruar.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Ç'të blejmë (Dhuratë për mua, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon idetë kryesore në tekste letrare dhe jo letrare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënimit për kompetenca kryesore të shkallës: I.4,7;; II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënimit të orës mësimore:  -Shkruan çfarë dhurate do ti bënte vetes.  -Analizon tekstin e lexuar.  -Përgatitë fjalorthin.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Hapet diskutim me nxënësit duke u drejtuar pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- A ju pëlqejnë dhuratat?</li> <li>- Kur merrni dhurata zakonisht?</li> <li>- Cila është dhurata më e bukur që keni pranuar?</li> <li>- Po ti, i dërgon dhurata dikujt tjetër?</li> </ul> <p>Udhëzohen nxënësit të punojnë në rubrikën Dhuratë për mua. Lexohen disa nga shkrimet.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet teksti duke u ndalur sipas paragrafëve dhe bëhen pyetjet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Si ju duken dy motrat?</li> <li>-Cila po mendon më shumë për të tjerët?</li> <li>-Cili është mendimi juaj për motrën e madhe?</li> <li>-Si kush do të veproje ti?</li> </ul> <p>Diskutohet në nivel klase teksti i lexuar.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit lexojnë tekstin dhe nënvizojnë fjalët e reja për ta. Punojnë në rubrikën fjalorthi.  Lexohen kuptimet e fjalëve të gjetura në fjalor.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në mësim me listë kontrolli.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Ç'të blejmë (Pyetjet, Të shprehurit me vizatim)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon idenë kryesore në tekstin letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I-3 ,7 II-5 ,III-,2,4  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2 . 1  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Arti figurativ.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Përgjigjet në pyetjet e dhëna.  -Shprehet me anë të vizatimit.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit udhëzohen të punojnë në rubrikën Pyetjet dhe sipas nevojës lexojnë tekstin në heshtje dhe me vëmendje. Nxënësit shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Nxënësit udhëzohen të punojnë në rubrikën Të shprehurit me vizatim..</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Pas përfundimit, nxënësit duke shëtitur nëpër klasë, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Përzgjedhen tri vizatimet më të bukura  Vlerësimi: Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Ç'të blejmë (Unë dhe personazhi, Shkruaj)  Tema :Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Dallon idenë kryesore në tekstin letrar.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I.4,7,; II.1, III.1,7, IV.3, V.1, VI.1  Rezultatet e fushës së kurrikulës: : 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Krahason veten me njërën nga personazhet e tregimit  -Shkruan një letër drejtuar personazhit.  Kriteret e suksesit: përcaktohen bashkë me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit zgjedhin personazhin me të cilin duan të krahasojnë veten. Udhëzohen të punojnë në rubrikën Unë dhe personazhi, duke plotësuar diagramin e Venit. Disa nga punimet prezantohen para klasës.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Nxënësit udhëzohen të punojnë në rubrikën Shkruaj një letër dy motrave</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Lexohen dhe komentohen disa nga letrat e shkruara.  Vlerësimi: nxënësit vlerësohen për letrat e shkruara.</p>



<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Djali dhe shqiponja (Shkruaj, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Shkruan një tekst rreth temës së dhënë.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 4, 5; ; III- 2, 4; IV-8, ;  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,4; 2 1,2,  Mjetet e punës: libri, lapsi.  Ndërlidhja me lëndët tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Tregon çfarë di për shqiponjën si simbol shqiptar.  -Shkruan një tekst me fjalët e dhëna në libër.  -Analizon tekstin e lexuar.  -Përgatitë fjalorthin.  Kriteret e suksesit: përcaktohen më nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Kërkohet nga nxënësit që të tregojnë çfarë dinë për shqiponjën, pse shqiponja është simbol në flamurin tonë etj. Udhëzohen nxënësit të punojnë në rubrikën Shkruaj në libër, ku ata duhet të krijojnë një shkrim me fjalët e dhëna dhe sipas kërkesave të dhëna. Nxënësit duhet të kenë kujdes te hyrja, zhvillimi dhe përfundimi i shkrimit. Po ashtu të kenë kujdes në drejtshkrim. Lexohen disa prej shkrimeve të nxënësve.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet teksti. Bëhen disa pyetje rreth tekstit, për të nxitur të menduarit kritik te nxënësit.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit lexojnë tekstin dhe nënvizojnë fjalët e panjohura. Pas përfundimit të leximit, plotësohet rubrika Fjalorthi duke përdorur fjalorin e gjuhës shqipe.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në të gjitha fazat e orës së mësimit, me ndihmën e listës së kontrollit.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Akrepat e orës (Ora, Fjalorthi)  Tema: Tekste letrare dhe jo letrare  Rezultatet e temës mësimore: Shkruan një tekst rreth temës së dhënë.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 1,3 ,6 ; II-2,5 ; III-2,3,7,; IV-2, 8; V-8,9, ; VI-2, 4.  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,3,4; 2 1,2,3,6; 4.1  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat.  Ndërlidhja me lëndët tjera :Jeta dhe puna, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Përshkruan orën si tregues kohe  -Vendos akrepat në orë sipas ngjarjeve ditore  -Analizon vjershën  -Përgatitë fjalorthin.  Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Nxënësit shkruajnë 5 ngjarje që bëjnë gjatë ditës, për të cilat duhet të shikojnë orën. Mandej, vizatojnë akrepat sipas ngjarjeve që bëjnë gjatë ditës.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Lexohet vjersha. Bëhen disa pyetje rreth vjershës, për të nxitur të menduarit kritik te nxënësit.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit lexojnë njershën dhe nënvizojnë fjalët e panjohura. Pas përfundimit të leximit, plotësohet rubrika Fjalorthi duke përdorur fjalorin e gjuhës shqipe.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në të gjitha fazat e orës së mësimit, me ndihmën e listës së kontrollit.</p>

<p>Fusha: Mësim me zgjedhje  Njësia mësimore: Familja ime  Tema: Libri im  Shkalla 2  Rezultatet e temës mësimore :Shkruan një tekst rreth temës së dhënë.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës: I- 1,3 ,6 ; II-2,5 ; III-2,3,7,,; IV- 2, 8; V-8,9, ; VI-2, 4.  Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,3,4; 2 1,2,3,6; 4.1  Mjetet e punës: libri, lapsi, ngjyrat  Ndërlidhja me lëndët tjera :Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:  -Shkruan një tekst për temën e dhënë.  -Shprehet me vizatim për temën e dhënë.  Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.</p>
<p><b>Hapi 1</b>  Me nxënësit diskutohet për rëndësinë e familjes dhe dashurinë për anëtarët e familjes.</p>
<p><b>Hapi 2</b>  Nxënësit shkruajnë një tekst për familjen duke u bazuar në diskutimin që është bërë dhe kërkesat në libër.</p>
<p><b>Hapi 3</b>  Nxënësit vizatojnë sipas kërkesës në libër.  <b>Vlerësimi:</b> Nxënësit vlerësohen për shkrimin dhe vizatimin e bërë.</p>